



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 1:	SISTEMI I PËRGJITHSHËM I MENAXHIMIT TË SSHP-SË
Tema 1.2.	DISPONUESHMËRIA DHE CILËSIA E DOKUMENTACIONIT TË VLERËSIMIT TË RISKUT, DISPONUESHMËRIA E SPECIALISTIT/EKSPERTIT TË CERTIFIKUAR PËR SSH, OFRUESIT TË LICENCUAR TË SHËRBIMIT PËR SSHP.
Ligji / rregulloret përkatëse:	Bazuar në: • Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë; • Rregullore (MPMS) Nr.02/2021 për vlerësimin e riskut në vendin e punës; • Rregullore (MPMS) Nr.01/2021 për kualifikimin e personave përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, licencimin e kompanive të shërbimeve dhe trajnimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë; • Rregullore (MPMS) Nr.02/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës.
Shkurtesa:	• PPM – Pajisje personale mbrojtëse • SSHP – Siguria dhe shëndeti në punë
Përdorimi i listës kontrolluese:	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Vërejtje për zbatimin
	PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNËS			
	<i>* Gjatë vizitës në vendet e punës, do të ju duhet të mbani shënime. Është më e lehtë të mbani shënime të strukturuar, për shembull duke përdorur formularët e inspektimit. Merrini me vete. Përmbajtja e formularëve të inspektimit varet nga vendi i punës që do të vizitoni. Nëse nuk keni formularë inspektimi, përgatisni formularë të mirë dhe lehtësisht të kuptueshëm (p.sh. duhet të përfshihet vendi i inspektimit, data/ora, ekipi i inspektimit dhe të punësuarit e inspektuar, lista e PPM-ve që kërkohen për të kryer detyrën/punën, etj.).</i>			

	<i>* Mund të ju duhet edhe të merrni me vete në lokacion një kopje të planit parandalues të aprovuar për të kontrolluar nëse në të kaluarën janë zbatuar masa parandaluese me afate për zbatim!</i>			
	MBIKËQYRJA E LOKACIONIT / VENDIT TË PUNËS			
	<i>* Bëhuni shembull, respektoni rregullat ekzistuese të sigurisë në lokacion / vendet e punës (vishni pajisjet e kërkuara personale mbrojtëse, respektoni shenjat e sigurisë etj.)!</i> <i>* Mbani shënime për vendet e vëzhguara të punës dhe bëni fotografi atje ku ekzistojnë rreziqe (kushtojini vëmendje shembujve të mirë me masa parandaluese të zbatuara dhe shembujve jo të mirë ku mungojnë masat parandaluese).</i> <i>* Bisedoni me të punësuarit, tregohuni miqësor, shpjegojuni dhe këshillojuni si mund të ndikojnë në shëndetin e tyre rreziqet në vendin e punës dhe cilat masa parandaluese duhet të merren për t'i mbrojtur!</i>			
1.	A ka rreziqe në vendet e punës që kanë nevojë për masa parandaluese? <i>* Përdorni Shtojcën 1 për identifikimin e rreziqeve në vendin e punës për të marrë shënime për vëzhgimet tuaja gjatë vizitës në terren. Mbani shënime edhe për masat parandaluese që mungojnë!</i> <i>* Analizoni 4-5 vende pune / procese, nëse është e mundur, zgjidhni aktivitete jo-rutinore, si punët e mirëmbajtjes ose pastrimit.</i>			
2.	A kanë qenë të përfshirë përfaqësuesit e punëtorëve dhe punëtorët që punojnë në vendin përkatës të punës në vlerësimin e riskut në vendin e punës? Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 5.4			

	<i>* Pyesni 3-5 punëtorë nëse e dinë si është bërë vlerësimi i riskut, nëse ata ose disa kolegë janë intervistuar në lidhje me kushtet e tyre të punës.</i>			
3.	A ka pasur ndonjë ndryshim në mjedisin e punës brenda dy (2) viteve të fundit? Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 15.1.2, 15.1.3 <i>* Kur ecni nëpër vendin e punës, diskutoni me udhëheqësin e departamentit përkatës / mbikëqyrësit dhe 3-5 punëtorë nëse ka pasur ndonjë ndryshim në mjedisin e punës brenda dy (2) viteve të fundit (për shembull, ndryshime në procedurat e punës, metodat, pajisjet e punës, përdorimin e substancave dhe përzierjeve të ndryshme kimike, vendi i punës ka pësuar modifikime thelbësore, etj.).</i> <i>* Më vonë kontrolloni dokumentet e vlerësimit të riskut në vendin e punës nëse këto ndryshime janë marrë parasysh në dokumentin më të fundit të vlerësimit të riskut në vendin e punës.</i>			
	KONTROLLIMI I DOKUMENTEVE NË ZYRË			
	<i>* Nëse keni një ofrues të jashtëm të shërbimit të SSHP-së ose ekspert për SSHP, takohuni me të.</i> <i>* Ftoni përfaqësuesin e të punësuarve të marrë pjesë në kontrollimin e dokumenteve.</i> <i>* Shpjegoni vëzhgimet tuaja të mira dhe jo të mira nga vizita juaj në vendin e punës.</i> <i>* Kërkoni dokumentin e vlerësimit të riskut në vendin e punës të vendeve të punës dhe / ose proceseve të punës që keni vëzhguar gjatë vizitës.</i> <i>* Krahasoni vëzhgimet tuaja të rreziqeve të identifikuar dhe shkeljet e SSHP-së me rreziqet e specifikuar në dokumentin e vlerësimit të riskut në vendin e punës (p.sh. nëse identifikoni skelet e pasigurta, shikoni në dokumentin e rreziqeve të "Punës në lartësi"</i>			

	<i>dhe kontrolloni nëse janë identifikuar skelet e pasigurta dhe janë specifikuar masat e duhura parandaluese).</i> <i>* Në rast se identifikoni rreziqet ekzistuese në vendin e punës, por nuk specifikohen në dokumentin e vlerësimit të riskut në vendin e punës, shpjegoni problemin dhe caktoni kohë për ta përmirësuar cilësinë (secila kompani është përgjegjëse për rishikimin e vlerësimit të riskut brenda dy (2) javësh pas kërkesës së bërë nga Inspektorati i Punës - mund të caktoni të njëjtën kohë);</i> <i>* Në rastet kur merrni përgjigje “Jo”, sqaroni situatën (p.sh. mungesa e dokumenteve), kërkonit dëshmi (p.sh. ndonjë dokument që mbështet trajnimin).</i> <i>* Tregohuni miqësor, shpjegojuni dhe këshillojini për obligimet e tyre në lidhje me vlerësimin e riskut në vendin e punës, nëse është e mundur, jepni shembuj të praktikës së mirë (p.sh. përfshirja e punëtorëve në kompani të tjera).</i>			
4.	A ka ndonjë dokument të shkruar për vlerësimin e riskut në vendin e punës? Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 11.1 <i>* Kërkonit dokumentin e vlerësimit të riskut në vendin e punës për 3-5 vende të punës dhe / ose procese të punës që keni vëzhguar gjatë inspektimit.</i> <i>* Në rast se nuk ka dokumente të shkruara të vlerësimit të riskut në vendin e punës, anashkaloni të gjitha pyetjet e mëposhtme.</i>			
5.	A janë përgatitur dhe nënshkruar dokumentet e vlerësimit të riskut nga një prej këtyre personave: ● Personat që zotërojnë kualifikim themelor për sigurinë dhe shëndetin në punë ● Personat që zotërojnë kualifikim të avancuar për sigurinë dhe shëndetin në punë ● Personat që zotërojnë certifikatë të ekspertit për sigurinë dhe shëndetin në punë;			

	● Kompani të licencuara si shërbime për sigurinë dhe shëndetin në punë? Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 2.1, Neni 11.4 Rregullore (MPMS) Nr.01/2021, Neni 3, 4, 5 <i>* Merrni parasysh sa punëtorë janë të punësuar në ndërmarrjen e vet. Zgjidhni në tabelë (Shtojca 2) qelinë përkatëse duke marrë parasysh industrinë në të cilën vepron kompania juaj dhe numrin e të punësuarve.</i> <i>* Vlerësoni nëse personi që e ka kryer vlerësimin e riskut në vendin e punës është në përputhje me Shtojcën 2.</i> <i>* Kontrolloni nëse e dispononi kopjen e certifikatës përkatëse të personave ose licencës së shërbimit për SSHP.</i> <i>* Kontrolloni nëse ka nënshkrime të personave përkatës në dokumentin e vlerësimit të riskut në vendin e punës.</i> <i>* Kjo është metoda për të kontrolluar nëse personi i ngarkuar për SSHP në kompaninë tuaj është në pajtueshmëri me aktet ligjore në lidhje me kërkesat e trajnimit dhe certifikimit.</i>			
6.	A e përmbajnë dokumentet informacionin e mëposhtëm: Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 11.2, 15.1			
6.1	Data e vlerësimit të riskut në vendin e punës <i>* Mos harroni se vlerësimi i riskut në vendin e punës duhet të bëhet jo më pak se një herë në dy (2) vjet.</i> <i>* Kontrolloni nëse data e dokumentit të vlerësimit të riskut në vendin e punës është më e re se dy (2) vjet nga data kur ju i kontrolloni dokumentet.</i> <i>* Nëse dokumenti i vlerësimit të riskut në vendin e punës është përgatitur më shumë se dy (2) vjet më parë, organizoni rishikimin e dokumenteve.</i>			

6.2	Emri i kompanisë;			
6.3	Identifikimi (emri) i vendit të punës ose procesit të punës (p.sh. departamenti, lidhja, lloji i punës etj.);			
6.4	Emrat dhe mbiemrat e personave që kryejnë vlerësimin e riskut në vendin e punës / emrin e shërbimit të sigurisë dhe shëndetit në punë;			
6.5	Emrat dhe mbiemrat e personave të tjerë të përfshirë në vlerësimin e riskut në vendin e punës;			
6.6	Listën e rreziqeve të identifikuar që ekzistojnë në vendin e punës;			
6.7	Përshkrimin e secilit rrezik të identifikuar në vendin e punës (p.sh. burimi i rrezikut, situata kur ndodh rreziku);			
6.8	Pasojat e mundshme pas ekspozimit ndaj secilit rrezik të identifikuar në vendin e punës;			
6.9	Referencat ndaj aktit ligjor të lidhur me rrezikun e veçantë në vendin e punës (nëse aplikohet). <i>* Kontrolloni nëse jepet referenca ndaj akteve ligjore që janë në fuqi në momentin kur është bërë vlerësimi i riskut në vendin e punës.</i>			
6.10	Nivelin e vlerësimit të riskut për secilin rrezik të identifikuar në vendin e punës;			
6.11	Masat parandaluese që duhet të merren për të eliminuar ose zvogëluar riskun.			
7.	A përfshihen në vlerësimin e riskut në vendin e punës përfaqësuesit e punëtorëve dhe punëtorët që punojnë në vendin përkatës të punës?			

	Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 5.4 <i>* Krahasoni rezultatet e intervistave me përmbajtjen e dokumenteve.</i>			
8.	Bazuar në identifikimin e rreziqeve në vendin e punës, a janë bërë matjet e mëposhtme laboratorike të rreziqeve në vendin e punës: Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 7.3, 7.4 <i>* Nëse duhen bërë matje, por ato nuk janë kryer, kontaktoni ofruesin përkatës të shërbimit për t'i organizuar ato.</i>			
8.1	Zhurma, nëse duhet;			
8.2	Dridhja në duar-krahë dhe tërë trupin, nëse duhet;			
8.3	Mikroklima (temperatura e ajrit, lagështia e ajrit dhe shpejtësia e ajrit), nëse duhet;			
8.4	Ndriçimi, nëse duhet;			
8.5	Përqendrimi i pluhurit në ajrin e vendit të punës, nëse duhet;			
8.6	Përqendrimi i fibrave (përfshirë azbestin) në ajrin e vendit të punës;			
8.7	Përqendrimi i kimikateve në ajrin e vendit të punës, nëse duhet;			
8.8	Rrezatimi optik artificial, nëse duhet;			
8.9	Fushat elektromagnetike, nëse duhet;			
8.10	Rrezatimi jonizues, nëse duhet;			

9.	A janë integruar në dokumentin e vlerësimit të riskut në vendin e punës rezultatet e lartpërmendura të matjeve laboratorike? Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 11.3			
10.	A janë bërë këto matje nga laboratorit i akredituar nga bordi kombëtar i akreditimit në përputhje me standardin ndërkombëtar: ISO/IEC 17025 “Kërkesat e Përgjithshme për Kompetencën e Laboratorëve të Testimit dhe Kalibrimit” dhe metodat dhe pajisjet e përdorura për të kryer matje laboratorike janë në pajtueshmëri me standardet përkatëse dhe aktuale evropiane ose/dhe ndërkombëtare dhe/ose udhëzimet e organizatave ndërkombëtare (p.sh. Organizata Botërore e Shëndetësisë)? Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 7.4, 7.5 <i>* Kontrolloni nëse është e disponueshme kopja e certifikatës së akreditimit.</i>			
11.	A është rishikuar dokumenti i vlerësimit të riskut në vendin e punës pasi kanë ndodhur ndryshimet në mjedisin e punës (nëse duhet)? Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 15.1.2 <i>* Krahasoni rezultatet e vëzhgimeve tuaja me dokumentet.</i> <i>* Mos harroni se shembujt e ndryshimeve janë si më poshtë: ndryshime në procedurat e punës, metodat, pajisjet e punës, përdorimin e substancave dhe përzierjeve kimike të ndryshme, vendi i punës ka pësuar modifikime thelbësore etj.</i>			
12.	A është rishikuar dokumenti i vlerësimit të riskut në vendin e punës pasi ka ndodhur një aksident në punë (nëse është e aplikueshme)?			

	Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 15.1.4 <i>* Në rast se ka ndodhur një aksident, vlerësimi i riskut në vendin e punës duhet të rishikohet brenda 2 (dy) javësh pas aksidentit.</i>			
13.	A është rishikuar dokumenti i vlerësimit të riskut në vendin e punës pas regjistrimit të sëmundjeve profesionale (nëse duhet)? Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 15.1.5 <i>* Në rast se është regjistruar një sëmundje profesionale, vlerësimi i riskut në vendin e punës duhet të rishikohet brenda 2 (dy) javësh pas regjistrimit.</i>			
14.	A u kushtohet vëmendje e veçantë gjatë vlerësimit të riskut në vendin e punës grupeve të cënueshme që janë nën risk të veçantë ose kanë nevojë të veçanta (nëse është e aplikueshme): Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 6.4			
14.1	Gratë;			
14.2	Gratë shtatzëna dhe gratë gjidhënëse;			
14.3	Të punësuarit në moshë të re;			
14.4	Të punësuarit në moshë të vjetër;			
14.5	Të punësuarit me aftësi të kufizuara;			
14.6	Të punësuarit me sëmundje ekzistuese.			
15.	A është i disponueshëm nga punëdhënësi një përshkrim me shkrim i metodës së përdorur për vlerësimin e riskut në vendin e punës? Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 7.2			

	<i>* Mos harroni - përshkrimi me shkrim i metodës është i nevojshëm vetëm nëse vlerësimi i riskut në vendin e punës sigurohet nga eksperti ose shërbimi i jashtëm për SSHP. Nëse ky është rasti juaj, kërkonte dokumentin nga eksperti ose shërbimi i jashtëm për SSHP.</i>			
16.	A është i disponueshëm një plan parandalues me masat e nevojshme për të shmangur, zvogëluar ose eliminuar riskun, duke përfshirë sa vijon: Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 10, 12 <i>* Kontrolloni nëse në të kaluarën janë zbatuar masa parandaluese me afate për zbatim! Nëse ato nuk janë zbatuar, gjeni arsyen e mosrespektimit të planit dhe planifikoni masat parandaluese!</i>			
16.1	Masat parandaluese për të eliminuar ose zvogëluar rreziqet në vendin e punës;			
16.2	Afatin e zbatimit të masave parandaluese;			
16.3	Personat përgjegjës për zbatimin e masave parandaluese;			
16.4	Financat e alokuara për zbatimin e masave parandaluese.			
17.	A është nënshkruar plani për parandalim nga menaxhmenti i lartë për të alokuar burime të mjaftueshme? Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 12.4			
18.	A është vlerësuar nëse risqet mund të shmangen ose të reduktohen në mënyrë të mjaftueshme nga mjetet teknike të mbrojtjes kolektive ose nga masat, metodat ose procedurat organizative të punës? Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Neni 7 Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 10.2			

	Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 4, 7.1.2 <i>* Kontrolloni dokumentin e vlerësimit të riskut për të identifikuar nëse është vlerësuar mundësia e zbatimit të masave të tjera parandaluese, diskutoni me ekspertin e SSHP-së.</i>			
19.	A janë zgjedhur PPM-të në bazë të vlerësimit të riskut të vendit të punës? Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 5.1, 5.2, 7.1 <i>* Kontrolloni lidhjen mes dokumenteve të vlerësimit të riskut (risqet e identifikuara), PPM-ve (referenca për standardet që shpjegojnë nivelin e mbrojtjes) dhe vëzhgimeve gjatë vizitës në terren.</i>			
20.	A keni mbajtur evidencë për masat e marra parandaluese (p.sh. regjistrimi i trajnimeve të të punësuarve, etj.)? Rregullore (MPMS) Nr.02/2021, Neni 13			



INSPEKTORATI I PUNËS

SHTOJCA 1

LISTA INDIKATIVE E RREZIQEVE KRYESORE NË VENDIN E PUNËS

RREZIQET NË VENDIN E PUNËS		Vendi i punës 1	Vendi i punës 2	Vendi i punës 3	Vendi i punës 4	Vendi i punës 5	Vendi i punës 6	Vendi i punës 7
	Rreziqet traumatike							
1	Sipërfaqe të pabarabarta ose të rrëshqitshme (të cilat mund të shkaktojnë rrëshqitje, pengesa, rënie etj.)							
2	Automjete lëvizëse (pirunë, kamionë, etj.)							
3	Pjesë lëvizëse mekanike të makinerive (p.sh. sistemet e konvejerëve)							
4	Objekte dhe pjesë me sipërfaqe të rrezikshme (të mprehtë, të ashpër, etj.)							
5	Sipërfaqe, materiale të nxehta ose të ftohta, etj. (p.sh. furra dhe boilerë)							
6	Puna në lartësi							
7	Puna në shkallë							
8	Objekte që bien							
9	Vegla dore (me dhe pa rrymë)							

10	Siguria elektrike (instalimet dhe pajisjet elektrike, tokëzimi dhe rrufepritisë)							
11	Siguria nga zjarri							
12	Shpërthimi							
13	Puna në hapësira të mbyllura							
14	Puna në gërmime							
15	Stabiliteti i sipërfaqes							
16	Hapjet në sipërfaqe dhe mure							
17	Pastërtia, rregulli në vendin e punës							
	Rreziqet fizike							
18	Zhurma							
19	Dridhje							
20	Ndriçimi							
21	Mikroklima e brendshme							
22	Klima e nxehtë ose e ftohtë (puna jashtë)							
23	Rrezatimi UV, IR, lazer dhe mikrovalë, rrezatimi jo-jonizues							
24	Rrezatimi jonizues							
25	Shtypje e lartë							
	Rreziqet nga kimikatet dhe pluhuri							
26	Substanca kimike dhe materiale të rrezikshme							
27	Pluhuri							
28	Korrozioni (ndryshku)							
29	Asbest							
30	Kancerogjenë, mutagjenë							
	Rreziqet psiko-sociale							

31	Ngarkesa, mbingarkesa, shterimi fizik dhe mendor							
32	Organizim i pamjaftueshëm i punës dhe komunikim i pamjaftueshëm me menaxhmentin dhe kolegët							
33	Dhuna, ngacmimi (mobbing/bulling)							
34	Puna i vetëm							
35	Puna me palë (klientë, konsumatorë etj.)							
36	Orari i punës, puna jashtë orarit, mungesa e kohës, menaxhimi i kohës							
37	Puna në ndërrime, përfshirë ndërrimet e natës							
38	Rreziqe të tjera që çojnë në stres në punë (p.sh ndryshimet e shpejta në procedurat e punës, situatat konfliktuale, përcjellja në vazhdimësi e inovacioneve dhe aplikimi i tyre në praktikë, puna me të holla, përgjegjësia gjatë punëve të ndërlikuara ku nevojitet marrja e vendimeve të shpejta).							
	Rreziqet ergonomike							
39	Ngritja dhe mbajtja e ngarkesave							
40	Puna që përfshin pozicion të dobët (pozicion të papërshtatshëm), lëvizje përsëritëse, shtrirje të zgjatur							
41	Puna me ekrane							

42	Mbingarkesa e zërit							
	Rreziqet biologjike							
43	Viruse, parazitë, myk, baktere							
44	Kafshë, gjarpërinj etj.							
45	Kontakti me insektet							



SHTOJCA 2

PERSONAT TË CILËVE U LEJOHET TË KRYEJNË VLERËSIMIN E RISKUT NË VENDIN E PUNËS NË VARËSI TË PËRMASËS SË KOMPANISË DHE INDUSTRIËS NË TË CILËN VEPRON KOMPANIA

sipas Rregullores (MPMS) Nr.01/2021 për kualifikimin e personave përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, licencimin e kompanive të shërbimeve dhe trajnimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë.

	Madhësia e kompanisë	
	Deri në 50 punëtorë	51 ose më shumë
Kompanitë në industritë me risk të ulët (të gjitha industritë me përjashtim të ndërtimtarisë, prodhimit, transportit, bujqësisë, pylltarisë, minierave)	<u>I brendshëm</u> • Vetë punëdhënësi nëse është trajnuar si specialist për SSHP • Specialisti për SSHP • Eksperti për SSHP <u>I jashtëm</u> • Eksperti për SSHP • Shërbimi për SSHP	<u>I brendshëm</u> • Eksperti për SSHP <u>I jashtëm</u> • Eksperti për SSHP • Shërbimi për SSHP
Kompanitë në industritë me risk të lartë (ndërtimtaria, prodhimi, transporti, bujqësia, pylltaria, minierat)	<u>I brendshëm</u> • Vetë punëdhënësi nëse është trajnuar si specialist i avancuar për SSHP • Specialisti i avancuar për SSHP • Eksperti për SSHP <u>I jashtëm</u> • Eksperti për SSHP • Shërbimi për SSHP	<u>I brendshëm</u> • Eksperti për SSHP <u>I jashtëm</u> • Shërbimi për SSHP